



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 2151/Prot.

Tiranë, më 02.12.2024

NJOFTIM PUBLIK

“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z. ARBEN XHYDOLLARI NË ZBATIM TË VENDIMIT 41-2024-1367 DATË 17.04.2024, GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË”

Njësia Administrative Udënisht, Pogradec

Referuar vendimit nr. 74-10 datë 02.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku znj. Leonora Canie është përfituese e Ndhmës Juridike Dytësore dhe përjashtuar nga tarifat gjyqësore.

Me Vendimin nr. 41-2024-1367 datë 17.04.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me palë paditëse znj. Leonora Canie dhe i paditur z. Arben Xhydollari me objekt “*Dhënia e autozimit paditëses për të udhëtar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe për të qëndruar përkohësisht jashtë shtetit, me fëmijën e mitur Luna Xhydollari, gjinia femër e datëlindjes 02.06.2014, pa miratimin me shkrim të të padituri*” ka vendosur:

1. *Pranimin e padisë;*
2. *Paditësja Leonora Canie autorizohet që të lëvizë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me fëmijën e saj të mitur Luna Xhydollari, e datëlindjes 02.06.2014 dhe për të jetuar përkohësisht jashtë shtetit me fëmijën e saj të mitur Luna Arben Xhydollari.*
3. *dhe në pikën 3 të dispozitivit të vendimit Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të paditurit.*

Në Vendimin përfundimtar gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore ***i lihen në ngarkim të paditurit.***

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimin e ofruar avokaten Inesa Grazhdani me vlerë 40 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Procedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 41-2024-1367 datë 17.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të shumës prej 40.000 lekë, të paguara nga ana jonë për shpërblim avokati, ofruar për përfituesen e ndihmës juridike dytësore falas dhe përjashtimit nga tarifat gjyqësore për znj. Leonora Canie.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Arben Xhydollari. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative, kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Njësinë Administrative Udënisht, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë.

Njoftimi quhet i bërë kur Njësia Administrative Udënisht depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

